



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 1

Rrogozhinë, më 29.01.2024 ora 12 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.334.Prot datë 24.01.2024 si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.10, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.12.2023.
- 3- Miratim i procesverbalit Nr.11, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 28.12.2023.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2023 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 6- Miratim i projekt - vendimit, “Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendosen në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”.
- 7- Të ndryshme.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Gezime Met-hasani, Erind Tosku, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Besnike Coraj, Altin Tosku, Mitat Daja, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Lulzim Hasa, Lije Dedej, Hekuran Xhani, Sokol Gosa, Ferdi Avdiu, Saimir Cani, Fatbardha Sina.



Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Rezart Vogli - Drejtor i Financës dhe Shërbimit Social.
4. Ledian Hasani - Përgjegjës i Shërbimit Social.
5. Luan Gjuzi - Përgjegjës i zyrës Juridike.
6. Sidorela Troka - Specialiste Juriste.
7. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, gjithsej 11- Këshilltarë.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Atëherë përshëndetje të nderuar Këshilltarë ! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje Këshilltarët : Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Gezime Met-hasani, Erind Tosku, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Besnike Coraj, Altin Tosku, Mitat Daja, Mukades Gixhari. Gjithsej jemi 11- Këshilltarë.

Lexojmë konfirmimin ligjor të ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë për Vendimet e Këshillit Bashkiak të datës 27.12.2023 dhe 28.12.2023.

Vendimi nr .32, datë 27.12.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”, konfirmohet.

Vendimi nr .33, datë 27.12.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2023 nga fondi i pushtetit vendor”, konfirmohet.

Vendimi nr .34, datë 27.12.2023 “Për miratimin e Paketës Fiskale viti 2024 për Bashkinë Rrogozhinë”, konfirmohet.



Vendimi nr .35, datë 27.12.2023 “Mbi realizimin Faktik të Buxhetit 2023 për Bashkinë Rrogozhinë”, konfirmohet.

Vendimi nr .36, datë 27.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 për Bashkinë Rrogozhinë”, konfirmohet.

Vendimi nr .37, datë 27.12.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë, të Njësive Administrative, të Institucioneve të varësisë, të punonjësve të Njësive Mbështetëse, të Kryetarëve të Fshatarve për vitin 2024”, konfirmohet.

Vendimi nr .38, datë 27.12.2023 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024”, konfirmohet.

Vendimi nr .39, datë 27.12.2023 “Për miratimin e listës së nxënësve që vazhdojnë studimet në institucionet e arsimit të mesëm profesional që përfitojnë bursë shteti për vitin shkollor 2023-2024”, konfirmohet.

Vendimi nr .40, datë 27.12.2023 “Për miratimin e bursave sipas VKM nr.666, datë 10.10.2019 për nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar për vitin shkollor 2023-2024”, konfirmohet.

Vendimi nr .41, datë 27.12.2023 “Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, konfirmohet.

Vendimi nr .42, datë 27.12.2023 “Për miratimin e Hartës së Plazhit Spille dhe Vilëbashtovë Bashkia Rrogozhinë në zbatim të VKM-së Nr.171, datë 27.03.2019, Për miratimin e Rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”. Konfirmohet në parim referuar ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar .

Vendimi nr .43, datë 27.12.2023 “Për një ndryshim në VKB Nr.19 datë 19.09.2023 për fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e strukturave komunitare në fshat”, konfirmohet.

Vendimi nr .44, datë 27.12.2023 “Mbi një shtesë në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.8, datë 30.06.2023 ‘Për miratimin e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë’ ”, konfirmohet.

Vendimi nr .45, datë 27.12.2023 “Për miratimin e programit të punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2024”, konfirmohet.

Vendimi nr .46, datë 27.12.2023 “Për emërtimin e dy rrugëve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”, konfirmohet.

Vazhdojmë me mbledhjen e datës 28 Dhjetor :

Vendimi nr .47. datë 28.12.2023 Për miratimin në parim të dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 0.5 ha parcela nr.42/a, ZK.2824 në fshatin Okshtun, Njësia Administrative Lekaj, Bashkia Rrogozhinë”.

Nuk konfirmohet pasi bie në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr.77/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.



Duke ju falenderuar për bashkëpunimin ,
Prefekt, Afrim Qendro.

Mukades Gixhari . Para se të kalojmë në rendin e ditës kemi një projektvendim shtesë, “Për projektin : Tungjatjeta jetë, Shërbim Lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar” të cilin e gjeni të fotokopjuar para secili. Jeni dakord ta përfshijmë në rendin e ditës këtë projektvendim? Ehedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro përfshirja në rendin e ditës e projektvendimit me shkresë Nr.362/1.Prot datë 29.01.2024 “Për projektin : Tungjatjeta jetë, Shërbim Lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar”.

Mukades Gixhari . Kalojmë në miratimin e rendit të ditës. Jeni dakord me...? Po z. Enver.

Enver Memolla . Marrë shkas nga pjesa e ligjshmërisë së vendimeve të këshillit bashkiak që vijnë nga Prefektura dhe shoh sërish që i njëjti vendim që vjen tre herë në këshill bashkiak kthehet prap si i pavlefshëm. Tani unë dua ta di si vjen në këshill bashkiak tre herë rresht kur nuk plotëson kushtet ligjore?

Edison Memolla . Ska... Vis shpjegoja pak. Atëherë vendimi ka kaluar është një VKM e nxjerrë nga shteti që këto prona nuk jepen në përdorim deri në 2024 ishte Vis?

Ervis Shera . Deri në 2024. Por rasti i dytë që ky vendim është kthyer, më fal Kryetar ka qenë për periudhën kohore që jepej me qera prona. Kurse në këtë rast është një ligj i 2022 sepse ne vendimin e dytë që është kthyer mbrapsht e kemi marrë në 2021-in, që thotë neni 4 i ligjit 2022 dhe neni 4 shprehet teksualisht: “... 4. Çdo pronë, e cila është pjesë e fondit të tokës, sipas pikës 1 të këtij neni, pavarësisht nëse u është kaluar e drejta e pronësisë ose e drejta e përdorimit njëjësive të qeverisjes vendore ose çdo autoriteti tjetër publik, që ligji i njeh të drejtën e transferimit të pronave të paluajtshme të shtetit, nuk mund të tjetërsohet, të rëndohet ose të disponohet në çdo mënyrë tjetër. Këto prona ruhen dhe mirëmbahen në gjendjen që janë dhe mbeten pjesë e fondit të kompensimit fizik në dispozicion të Agjencisë së Trajtimit të Pronave”.

Enver Memolla . Pyetja që lind ky nen që ka dalë është i 2022-it?

Ervis Shera . Është ligji i 2022-it, kurse në 2021 që është marrë...

Enver Memolla . Jo nuk po flas për këtë vendim në 2022-in në 2023 vjen projektvendimi pa u



lexuar ai ligj pastaj. E kam idenë këtu që të jemi transparentë dhe me njerëzit jashtë dhe me veten tonë, që të mos kalojmë projektvendime në këshill bashkiak dhe të tregojmë që ne jemi nivel i ulët në Prefekturën e Tiranës sepse realisht unë e thashë herën që kaloi nëse janë ndjekur taman procedurat ligjore për tu bërë vendim. Se nuk është i pari në këtë pjesën kalon nuk kalon të jemi të qartë me veten tonë në radhë të parë edhe për të rritur standartin si të bashkisë si të këshillit. Por dhe ta dimë ta kalojmë dhe të vijë nga prefektura i paligjshëm këtu e kam, se realisht ndërpritet dhe vrulli i investitorëve tani që mund të vijnë.

Indrit Dedej . Në qoftë se ne e kalojmë këtë që thotë prefektura nuk është kaluar dhe i konfirmojmë këto të prefekturës, ne konfirmojë për çfarë ka konfirmuar prefektura nuk do të thotë që e ka nxjerrë prefektura që nuk e konfirmon dhe ne ta votojmë prap. Tani ma shpjego pak?

Ervis Shera . Jo nuk e kemi sjellë për votim.

Indrit Dedej . Ta dimë të paktën .

Mukades Gixhari . Është përgjigja e Prefekturës.

Indrit Dedej . Në raste të ngjashme një person ka dokumentacion të rregullt, që të jemi dhe ne të qetë jo vjen një hartë sot për një orë bëhen projektet, se kuptoj se sa i zoti ka qenë ajo apo ai që ka bërë planin e biznesit për 2-3 orë që me datë 28 u konfirmua prap. Gjërat nuk bëhen me të imponuar, bëhen çfarë procedurash ka, çfarë dokumentacioni duhet, kemi 5 pika t'i zbatojë, t'i sjelli , t'i kalojmë.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Atëherë kalojmë në miratimin e rendit të ditës. Jeni dakord me rendin e ditës? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Pika 2, “Miratim i procesverbalit Nr.10, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.12.2023”. Bëhet fjalë për mbledhjen e Dhjetorit. Jeni dakord ta hedhim në votim? Pro, kundër, abstenim? Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . E njëjtë gjë për procesverbalin Nr.11, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak



datë 28.12.2023. E hedhim në votim? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 3 (tre) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2023 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”. Do na relatojë drejtori i financës dhe shërbimit social z. Rezart Vogli. Përshëndetje z. Rezart.

Rezart Vogli . Përshëndetje të gjithëve. Meqë përgjegjësi i shërbimit social është me leje të zakonshme për ndihmën ekonomike bllok 6% për muajin Dhjetor 2023 janë gjithsej 17-familje me një fond total 63 001 (gjashtëdhjetë e tremijë e një) lekë.

Mukades Gixhari . Ndonjë diskutim rreth kësaj pike? Atëherë e hedhim në votim? Pro, kundër abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr .1. Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.197.Prot datë 16.01.2024, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6% “.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 5, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2024 nga fondi i pushtetit vendor”. Relaton përsëri drejtori i financës dhe shërbimit social z. Rezart Vogli.

Rezart Vogli . Për ndihmën ekonomike 3 % muaji i cili miratohet sot është Janar 2024, për muajin Janar janë gjithsej 10 familje dhe fondi total është 60 444 (gjashtëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e katër) lekë. Fondi 3 % është fond që mbulohet nga Bashkia Rrogozhinë.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje rreth kësaj pike. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr .2. Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.271.Prot datë 18.01.2024, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2024 nga fondi i pushtetit vendor“.



Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 6, Miratim i projekt - vendimit, “Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendosen në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”. Do të relatojë nga Bashkia Rrogozhinë znjsh. Enkela Ballabani.

Edison Memolla . Para se të marri fjalën Enkela doja të thoja dhe unë diçka se dhe kur bëmë mbledhjen e fundit të këshillit bashkiak, diskutuam për ngritjen e sektorit të policisë bashkiake në një nivel tjetër. Jo vetëm të policisë bashkiake por dhe mbrojtja e konsumatorit nëpër tregje dhe në gjithë ato pika të rrezikshme për komunitetin. Dhe kemi menduar në bazë të paketës fiskale, të ngremë disa pika kundravajtje më të larta seç kanë qenë... me një fjalë minimum maksimum, kemi shkuar në ato mënyra që mendojmë që është më e përshtatshme sipas edhe qytetit duke i dhënë policisë bashkiake një autoritet tjetër duke e ngritur edhe stafin ku do bëjmë edhe thirrje që brenda javës do bëjmë një thirrje publike kush ka dëshirë vajza dhe djem të jenë pjesë e kësaj policie bashkiake i ftojme të gjithë të bëhen siç kanë rregulloret në bazë të kushteve paraprake që i takon, bëhet provimi i asaj gjëje dhe kush ka dëshirë unë e ftoj publikisht meqë jemi dhe online, të bëhet pjesë e kësaj strukture. Kështu që këto janë masa administrative që më gjatë do i shpjegojë Enkela. Kështu që do doja mirëkuptimin tuaj sepse të gjithë bashkë siç e kemi ngritur dhe për hapësirat publike apo për gjithë pjesët që janë ndikim parkimet e gabuara, pjesën e plazhit sepse kemi një vijë bregdetare që duhet me e pasur në vëzhgim sepse e keni parë vetë se çfarë bëhet. Kështu që po keni ndonjë sugjerim besoj se e keni lexuar, ka qenë aty i mirëpresim me shumë kënaqësi. Shumë faleminderit, Enkela mund të vazhdojë me prezantimin.

Enkela Ballabani . Atëherë siç e tha dhe kryetari ky projektvendim bëhet për t’i dhënë një mundësi policisë bashkiake të ketë edhe më shumë të drejta për të bërë ushtrimin e aktivitetit të tyre në sigurinë publike në qetësinë publike dhe në mbrojtjen e qytetarëve të bashkisë Rrogozhinë. Projektvendimi që propozohet përcakton rregulla të përgjithshme dhe standarte të sjelljeve të jetës qytetare në Bashkinë e Rrogozhinës dhe në të gjithë njësitë e saj. Kundravajtjet administrative në fakt siç dihet janë të përcaktuara që janë shkelje me faj të dispozitave ligjore dhe nënligjore me veprime apo mosveprime të cilat ligji i parashikon si dënime administrative. Në këtë rast në anën tonë të Bashkisë së Rrogozhinës dënimi administrativ është gjoba . Projektvendimi përcakton normat dhe rregullat që shërbejnë në ruajtjen e rendit publik pra siç e thashë dhe më përpara ndaj do të ishte shumë e rëndësishme që ne ta kishim si projektvendim në bashkinë e Rrogozhinës. Synon kryesisht që përpara se të ndëshkojë të edukojë qytetarët, t’i ndërjegjësojë ato për një bashkëjetesë qytetare sa më të rregullt brenda bashkisë tonë. Pika e parë që do të ndalesha është tek paralajmërimi me shkrim që është kryesorja si ndëshkim që subjektet që janë që rezultojnë të pandëshkuar më parë, bëhet paralajmërimi me shkrim më pas shkon tek dënimi me gjobë nëse rezulton dhe njëherë tjetër si recidivist apo i dënuar. Në projektvendim janë nene që përcaktohen, fillon me nenin 6 që parashikon veprimtaritë e lejuara



në bashkinë e Rrogozhinës është më pas neni 7 në zënien e hapësirave publike në kundërshtim me ligjin dhe më pas është neni 10 ku bëhet kundravajtja në fushën e sigurisë publike në nenin 9 pastaj është në fushën e qetësisë publike në nenin 10 kundër moralit dhe neni 11 kundër mjedisit dhe neni 12 të infrastrukturës publike. Këto nene janë të rëndësishme sepse plotësojnë vakumin ligjor që në Bashkinë e Rrogozhinës nuk ekzistojnë deri më sot. Është e rëndësishme që të votohen nga këshilli bashkiak sepse siç e thashë edhe më përpara janë shumë të rëndësishëm për të rregulluar bashkëjetesën shoqërore dhe qytetare në gjithë bashkinë e Rrogozhinës. Për sa i përket gjobave që janë parashikuar në nenin 16 janë edhe në bashkëpunim me paketën fiskalepra nuk është se janë në kundërshtim me njëra tjetrën kemi marrë të gjitha në bazë të paketës fiskale dhe më pas nenet e tjera që janë sidomos nga policia bashkiake kemi vënë disa dënime me gjobë të cilat ne mendojmë se janë brenda ligjit dhe që janë në përputhje dhe me veprat penale që mund të jenë siç është siguria publike në fushën e zënies së hapësirës publike etj. Nuk e di nëse ka ndonjë pyetje.

Mitat Daja . Kam unë një pyetje për Enkelën. Dakord do vihen masat është shumë mirë që bëhet kjo gjë. Unë prisja erdha dje në komision edhe nuk erdhi asnjë faktikisht që të ma shpjegonte pak më drejtë kështu. Supozojmë vihet një masë administrative pa të drejtë, ka mënyrë se si revokohet, është parashikuar?

Enkela Ballabani . Po, patjetër mund të shkojë në gjykatën administrative çdo person i cili ...

Mitat Daja . Jo, thashë a ka ndonjë institucion brenda bashkisë edhe për informacion jo se kam ndonjë gjë me tendencë?

Enkela Ballabani . Brenda bashkisë jo, apelimi duhet të bëhet në gjykatë.

Mitat Daja . Vetëm në gjykatë për një gjobë 50 mijë lekëshe psh?!

Amarildo Duka . Deri në 20 mijë është gjoba.

Mitat Daja . Është parashikuar nëse paguhet gjoba brenda...siç e kanë gjobat e policisë në qoftë se paguan brenda dy javëve paguan gjysmën, janë parashikuar të tilla gjëra?

Edison Memolla . Policia e shtetit ka dhe gjoba më të rënda se këto që kemi bërë. Ne kemi bërë një tavan dhe mendojmë që ta nisim njëherë dhe pastaj gjatë kohës mund të shikojmë mund ta rregullojmë . Gjithë ky sistem që po flasim do angazhohemi me e-albania çdo gjë të jetë online. Kur merr një gjobë të shkon online dhe nuk merr asnjë lloj shërbimi pa paguar atë gjobën, ky



është qëllimi i gjithë gjësë që mos ngeli gjoba as tek polici ta mbajë bllokun në xhep askush dhe çdo gjë të jetë transparente sipas asaj që do veprohet, transparenca është mbi të gjitha.

Mitat Daja . Që duhet të ketë masa kjo nuk diskutohet, pyetja ishte që ankimimet në bashki ekzistojnë apo jo?

Enkela Ballabani . E kemi lënë pjesën për tek gjykata administrative për shkak se duam që edhe qytetarët në momentin që marrin një masë administrative të jenë edhe më të bindur edhe më të qartë të shkojnë në gjykatë atje gjejnë nëse është e duhura apo jo. Se po ta bëjë një komision apelimi këtu brenda për brenda bashkisë së Rrogozhinës besoj se mund ta anashkaloheshin por në gjykatë administrative personi ka dhe më shumë akses.

Mitat Daja . Nëse nuk paguhet gjoba, çfarë do ndodhë? E marr një gjobë se paguaj.

Enkela Ballabani . Patjetër që rritet kamatvonesa e keni dhe të përcaktuar në bazë të kodit administrativ më fal ta gjej.

Mitat Daja . Mirë se ne shikojmë edhe është parashikuar si do vilet gjoba. Marrim një shembull ka fëmijë që kanë braktisur shkollën, se ne jemi mësues dhe e dimë këtë gjë, kanë braktisur shkollën nuk vijnë në shkollë. Mirë po ato trajtohen dhe me ndihmë ekonomike, trajtohen edhe me shërbime të tjera, unë nuk po them mos trajtohen mos keqkuptohet puna. Ka ndonjë gjë që i detyron që t'i sjelli fëmijët në shkollë, apo të paguajë gjobën ky është pyetja?

Enkela Ballabani . Gjoba do jetë e regjistruar në drejtorinë e taksave në momentin që ky qytetar rezu;ton një masë administrative ndaj tij. Në momentin që i drejtohet bashkisë, se janë të gjithë strukturat aty që do bashkëpunojnë me njëra tjetrën, në momentin që kërkon një shërbim nga Bashkia e Rrogozhinës dhe rezulton që ky person nuk e ka paguar gjobën që ka marrë nuk do t'i jepet asnjë shërbim.

Mitat Daja . Pra ju keni krijuar këtë infrastrukturë. Është krijuar infrastruktura që do lidhet me e-albanian me sistemin që keni ju brenda bashkisë. Për këtë po pyes, ju keni krijuar një infrastrukturë online që nëse personi nuk ka kryer këtë veprim ose supozojmë edhe për lënien e arsimit braktisjen e shkollave se shohim shumë fëmijë që janë rrugëve. Braktisja ka infrastrukturë unë për këtë pyes? Ka.

Enkela Ballabani . Struktura patjetër. Është ngritur edhe struktura e borxhit në drejtorinë e taksave.



Silvana Aliu . Në radhë të parë këto fëmijë që kanë braktisur shkollën unë nuk e kuptoj se çfarë thotë Mitati sepse nuk ke çfarë i merr këtyre se ai po të jetë në atë gjëndje i bie që të shkojë deri aty se ky është komuniteti rom dhe egjiptian që e kanë braktisur këtë dhe nuk kemi çfarë i marrim atyre. Por problemi është mos mbërrimë deri aty, fillojmë njëherë më atë që the në fillim pastaj ato masat asnjë nuk do i paguajë në Rrogozhinë.

Enver Memolla . Tani pa shkuar tek masat dua të them njëherë pjesën tjetër sepse mirë masat por duhet të plotësohen kushtet e para dhe nuk e di nëse tregjet e bashkisë Rrogozhinë i plotësojnë standartet që policia bashkiake të shkojë të vejë gjobë atje?

Amarildo Duka . Kemi parashikuar ne që do bëjmë edhe një treg .

Edison Memolla . Treg lëvizës me tavolina brenda kuadrit që kanë higjenë. Është pazari në Gosë ditën e Mërkurë, do spotohet që tavolinat në bazë të...

Enver Memolla . Arsyeja që ndërhyra para dy vitesh në mos gaboj ka ardhur AKU-ja në tregjet Rrogozhinë dhe ka vendosur gjoba 500 mijë lekë e lart 200 mijë e lart si për banorët që mund të jenë kasapë dhe therin, si për bulmetin që shesin, ullirin gjëra të tjera apo djathin që kanë në fuçia. Tani nëse nuk kanë kushte ku ta shesin nuk do lejohet ta shesi në tregun e Gosës, Rrogozhinë, Luz apo ku ka treg apo bashkiaku do i vejë gjobën? Sepse këtu pastaj ndodh precedenti ve gjobë dhe apelo në administrative.

Edison Memolla . Nuk është qëllimi që të vihen gjoba ideja është të sensibilizohen.

Enver Memolla . Merren masa për krijimin e infrastrukturës në radhë të parë, në muajin Gusht ne e dimë shumë mirë se ai tregu jonë aty nuk është treg normal dhe normalisht të gjithë mund të shesin në rrugë se nuk ka vend sa përdroin ato freza makina çfarë kanë por problemi është të krijohen kushtet e para se të fillohet procedimi. T'i krijojmë kushtet që edhe ai blegtori që është lart në malësi kur të vijë ta shesi djathin të paguajë tarifën, rrit të ardhurat dhe cilësinë.

Indrit Dedej . Nuk shkon dot në gjykatë për 20 mijë lekë.

Edison Memolla . Kur venë gjobë për makinën është diçka tjetër kur venë për tregun po e quajmë kështu do jetë komision nuk do jetë një do jenë tre.

Indrit Dedej . Ai sa herë e sheh i ve gjobë.



Edison Memolla . Kemi zyrë ankimimi për një qytetar që merr ka dhe kundërmasë për atë që shkel ligjin.

Indrit Dedej . Se unë kam pasur rast në gjykatë vetë.

Edison Memolla . Ne mendojmë që i kemi në rregull në moment që ka një parregullsi vjen bëhet kundërshtimi.

Mitat Daja . Pyetja ime ishte për Enkelën faktikisht pavarësisht se përgjigjet Silvana zakonisht. Por nuk dua që të ja shpjegoj Silvanës se ajo e kupton vetë. Pyetja ishte shumë e thjeshtë që ta kuptojë Enkela, dakord këto masa duhen sepse ndërhyrja që bëjnë këshilltarët e tjerë nuk është normale por ne do i tejkalojmë këto por unë e kam me ty pyetje dhe përgjigje, se kush flet pastaj le ta mbajë vetë përgjegjësinë. Dhe pyetja është shumë e thjeshtë është ndërtuar një infrastrukturë siç tha dhe Veri, infrastrukturë ligjore por dhe infrastrukturë për të shërbyer njerëzit sepse ti nuk mund të pengosh shërbimet shtijet edhe duhe me e parë edhe këtë gjë. Dakord kjo le të kalojë edhe unë jam dakord që të kalojë por se mendoni që të ketë bashkëpunim të ketë dhe efikasitet çdo gjë nesë nuk ka efikasitet puna ne flasim kot këtu, kjo është ideja.

Enkela Ballabani . Miratimi i këtij projektvendimi është baza kryesore, më pas, pas miratimit natyrisht ë Bashkia e Rrogozhinës me të gjithë strukturat e veta që ka do të kalojë në bazë të projektvendimit do marri masat e nevojshme që e gjithë puna të shpërndalet. Dhe në të njëjtën mënyrë përveç edukimit ndërgjegjësimit të qytetarëve në momentin që vihet dhe gjoba pastaj do ketë dhe masa për të ndjekur.

Silvana Aliu . Meqë m'u përmend emri në përgjigje të këshilltarit, këshilltar i nderuar nëse një nxënës braktis shkollën do të thotë 99% e rasteve e ke ti fajin si mësues 1 % e ka ...

Enver Memolla . Gjobat do jenë manuale me mandat pagese apo do jenë elektronikisht?

Edison Memolla . Do flasim me e-albania, jemi duke ngritur hap pas hapi... kjo është baza që ne të kemi.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim? Pro, kundër abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro, pika 6-të e rendit të ditës.

Vendim nr.3. Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me



shkresë Nr.323.Prot datë 24.01.2024 “Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendosen në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 7 të ndryshme. Projektvendimi për miratimin e fondit Për projektin : Tungjatjeta jetë, Shërbim Lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar”. Do ne relatojë përsëri drejtori i financës dhe shërbimit social z. Rezart Vogli.

Rezart Vogli . Programi tungjatjeta jetë është viti i 4-ët që kërkohet në vitin e 4-ët të këtij programi , ky program i vjen në ndihmë 36- fëmijëve të territorit të bashkisë Rrogozhinë që janë fëmijë me aftësi ndryshe. Ishte menduar dhe miratuar nga ana e bashkisë me buxhetin e vitit që miratuar në fund të Dhjetorit pasi nuk kishim informacin që do vazhdohej financim nga ana e ministrisë dhe që miratuar që ky program të ishte pjesë e strukturës së bashkisë. Po meqenëse nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale vjen një fond i akorduar pjesë e fondit social në mbështetje të këtij programi ne duam dhe na erdhi ditën e Premte datë 26 kjo shkresë dhe menduar që ta kalonim me qëllim që të mos i ndërprehet shërbimi këtyre fëmijëve me aftësi ndryshe në territorin e Bashkisë Rrogozhinë. Tre vitet e para ky program është iniciuar nga “Ëord Vision” 2 vitet e para është financuar nga ana e tyre vitin e tretë ky program kaloi në mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe sot që flasim është prap në mbështetje të ministrisë së shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale dhe fondi është 2,192,016 duke parë tabelën e miratuar të pagave që miratojmë për muajin Dhjetor është mund të thuash që 6 punonjës që janë pjesë të këtij programi, aktualisht janë 5, meqë fondi miratohet për 6 punonjës është miratuar menduar dhe bërë llogaria që ngritja e pagave të jetë për këto punonjës me qëllim që të ketë barazi për të gjithë. Fondi i financuar nga Bashkia është 2,301,600 thuhet 50 me 50.

Edison Memolla . Ky është një program që ka qenë për 3 vite në Bashkinë Rrogozhinë, viti i 4 ky që flasim gjithmonë kemi pasur bashkëpunimin ose të Ministrisë ose të Institucioneve joqeveritare, jofitimprurëse realisht ne e kishim menduar ta shikonim në strukturën e bashkisë, në bashkëpunim me ministrinë gjetëm mirëkuptimin e atyre që dhe ato të jenë pjesëmarrës në këtë shumë në shërbim të komunitetit na u pranua thirrja jonë edhe jemi aty ku tha dhe drejtori 50 me 50. Pesëdhjetë i fut Bashkia rrogat e tyre pesëdhjetë i jep ministria e shëndetësisë. Kështu që kjo është një gjë e mirë që ky shërbim të vazhdojë, t'i shërbehet fëmijëve me aftësi të kufizuar por dhe ne pretendojmë që ta ngrejmë akoma më shumë, faktikisht kemi bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të ngrehet një qendër reale ku këto fëmijë të thirren të aktivizohen dhe pse jo të krijohen kushte për të pasur lojëra për aktivitete të ndryshme. Sepse ne e dimë shumë mirë çdo prind që e ka një fëmijë të atillë është një sakrificë e madhe sadopak ne t'i gjendemi pranë me këto shërbime kështu që kjo është një gjë që duhet mundësisht po të jetë më shumë do jetë më mirë por mundësia është kaq dhe do vazhdojmë hap pas hapime këtë pjesë kështu që ... fjala është për ju.



Enver Memolla . Ky është viti i dytë që vjen në Këshill Bashkiak për të kërkuar fondet e bashkisë, ka ardhur vjet që u bë një ndryshim fondi në buxhet kjo është hera e dytë është një gjë e mirë që vazhdon në bashkinë Rrogozhinë. Pyetja është thjeshtë më shumë për informacion se nuk e kam të saktë, ky shërbim tek një fëmijë shkon njëherë në javë? Apo gjatë gjithë kohës?

Rezart Vogli . Sipas grafikut.

Enver Memolla . Sepse 6 punonjës për 36 vetë e mbulojnë shkojnë çdo ditë apo këtë informacion...?

Edison Memolla . Një është logopedist, një është fizioterapist, një është psikolog.

Rezart Vogli . Kanë një plan pune edhe 2 herë në javë në bazë të mundësive. Kanë hasur vështirësi siç e tha dhe kryetari se nuk kanë pasur një qendër të mirëfilltë për të kryer këtë shërbim është dashur në shumë raste këtë shërbim ta ofrojnë nëpër shtëpia. Ky program është iniciuar dhe e ka marrë këtë formë në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave përkatëse të cilët kanë referuar rastet e fëmijëve që janë me aftësi ndryshe. Nga ana e Bashkisë pastaj është bërë mundësia që ky program të ekzistojë.

Fatmira Thartori . Atëherë mesa dëgjova aty nuk ka vend që të bëhet konkretisht në Bashkinë tonë një qendër të atillë. Unë do thoja dhe do sugjeroja që të gjithë shkollat, se një pjesë e madhe e shkollave të bashkisë Rrogozhinë janë përfshirë në projektin e pasdites që është shkolla qendër komunitare. Dhe shkollat e reja që janë bërë tani së fundmi kanë edhe dhomë përkatëse madje dhe me krevat për infermierin, pra po jua sugjeroj këtë pjesë që të gjithë shkollat e reja e kanë këtë. Dhe mund të jetë vendi i përshtatshëm ku fizioterapisti apo kushdo qoftë është pjesë e këtij programimund ta kryejë sa më mirë atë pjesë. Dhe kur themi që është shkollë qendër komunitare nuk mbyllet gjatë gjithë kohës por është e hapur pra për komunitetin dhe të vihen në lëvizje pastaj instancat e tjera drejtoritë e gjitha tjerat që t'i mbajnë këto shkolla të hapura dhe të bëhet taman qendër komunitare dhe është edhe zgjedhje për të gjithë.

Alime Hoxha . Tani ky stafi shkon nëpër çdo shtëpi? Sipas një plani pune shkon atje sepse ne kemi një qendër ajo qendra do jetë në Rrogozhinë dhe ai tjetri nga Kryevidhi ka apo nuk ka kohë ta sjelli fëmijën.

Rezart Vogli . Në Rrogozhinë kemi pasur bashkëpunim me myftininë e cila në shumë raste na ka liruar ambientet e godinës anash xhamisë ku vajzat kanë ofruar shërbimin.



Edison Memolla . Komuniteti mysliman na ka lënë një pjesë të godinës në shërbim kanë qenë bashkëpunues tek kjo pjesë.

Alime Hoxha . Po për njësitë?

Edison Memolla . Për njësitë nëse ne arrijmë të krijojmë një qendërdo e gjejmë mundësinë të ja krijojmë edhe pjesën e rrugës për të ardhur deri aty nuk ngel ne të krijojmë qendrën se pastaj rruga 36 fëmijë sa do i kushtojë, bashkë me ju do e kalojmë një projektvendim për pjesën e asaj.

Rezart Vogli . Është menduar nga ana e Bashkisë Rrogozhinë duke parë që ka mungesë për logoped për këtë projekt të mundësohet një infermiere siç tha dhe zysh Fatmira pak më parë ne e kemi menduar, e citova pak më parë dhe tek struktura që e kemi miratuar. Aktualisht tek ky projekt flasim vetëm pagat dhe sigurimet shoqërore, Bashkia Rrogozhinë merr përsipër krijimin e komplet logjistikës që i nevojitet stafit për kryerjen e këtyre .

Fatmira Thartori . Puna është mos mbeti thjeshtë në letër apo të shkojë nëpër shtëpia por puna është të bëhen konkretisht, pra ai që po e merr pagën të bëjë punën, po shpërblehet dhe të japë frytet.

Edison Memolla . E ke me fakte me video çdo gjë.

Fatmira Thartori . Shkollat janë taman qendra për t'u bërë këto.

Silvana Aliu . Unë jam dakord por do ishte më mirë që të ngrihej një qendër. Ke dhe punonjës të arsimit special kurse infermiere është diçka tjetër.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi me shkresë Nr.362/1.Prot datë 29.01.2024 “Për projektin : Tungjatjeta jetë, Shërbim Lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar”

Vendim nr.4. Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.362/1.Prot datë 29.01.2024 “Për projektin : Tungjatjeta jetë, Shërbim Lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar”.

Mukades Gixhari . Të nderuar Këshilltarë kemi një kërkesë të drejtuar Këshillit Bashkiak Rrogozhinë, Këshilltaret e Njesisë Administrative Gosë që përcaktojnë dy forcat politike,



konkretisht Fatmira Thartori e forcës politike PS dhe Besnike Coraj e forcës politike PD kërojmë: Që në fshatin Kalush të Njësisë Administrative Gosë të bëhen dy kryepleq, mbetemi me shpresë se kërkesa jonë do të merret në konsideratë nga të gjithë këshilltarët. Me respekt të dyja zonjat e nderuara Fatmira Thartori dhe Besnike Coraj.

Edison Memolla . Vis, ana ligjore?

Ervis Shera . Nga ana ligjore ne ja përcjellim zyrës juridike të shikojnë anën ligjore dhe të na e sjellin pastaj.

Enver Memolla . Kjo është miratuar fillimisht për miratim dhe kemi qenë të gjithë dakord, tani rritet popullsia apo rritet territori?

Besnike Coraj . E pashë të arsyeshme nga popullsia shumë e larguar në fshatin Kalush, ka një popullsi ndryshe nga fshatrat e tjerë që janë braktisur duke parë që dhe Gosa Vogël ju dha kjo mundësi.

Fatmira Thartori . Sipërfaqja.

Besnike Coraj . Po dhe banorë dhe sipërfaqja pak e madhe e fshatit, është nga fshatrat më të banuar besoj të bashkisë.

Edison Memolla . E marrim në konsideratë, ja përcjellim zyrës juridike.

Besnike Coraj . Unë nuk kuptoj fare nga këto por Fatmira sugjeroi e bëjmë kështu.

Edison Memolla . Ne ja kalojmë zyrës juridike në bazë të ligjeve në bashkëpunim dhe me Prefekturën dhe me Këshillin Bashkiak nëse është çdo gjë e ligjshme nuk ka asnjë lloj pengese nga ana e bashkisë.

Fatmira Thartori . Ka ngelur pezull zgjedhja e kryepleqve.

Mitat Daja . Meqë jemi tek të ndryshme kam një kërkesë këtu nga një person e njohin ato që janë Rrogozhinas ëshë Avdulla Gjuzi sëmurë ka dy vjet që kurohet ka filluar dhe dializën dhe ka një sëmundje shumë të rëndë dhe ka paraqitur një kërkesë për të mbuluar sado pak shpenzimet spitalore. Nëse është unë e kam marrë përsipër ta paraqes në Këshill Bashkiak këtë kërkesë shpresoj nga kolegët që ta miratojnë dhe të ja përcjellin këtë drejtorisë së financës sipas asaj nuk



e kam idenë se kush e merr pastaj kërkesën por shpresoj në mbështetjen tuaj në këtë lloj rasti për ta ndihmuar sado pak këtë njeri. Se në pamje mund të duket sikur nuk ka nevojë por në të vërtetë sëmundja e tij është e rëndë tani është futur në dializë është futur në operacion dhe vërtet duhet me i dhënë nuk e di sa është mundësia nga Bashkia të jepet, kjo duhet parë ana ligjore, po të gjendet mundësia për ta ndihmuar.

Enver Memolla . I bie që kjo është tek ndihmat e menjëhershme...

Edison Memolla . Të silllet projektvendimi, 30-50 mijë lekë është.

Enver Memolla . 30-50 mijë lekë të reja është ose 500 mijë lekë të vjetra maksimumi.

Mitat Daja . Në rregull t'i japim ...

Enver Memolla . Për shpenzime spitalore prandaj po ndërhyja.

Mitat Daja . Aq sa është mundësia unë nuk e kam idenë sa është sa e lejon ligji të ndihmojë Bashkia, unë shpresoj që ta miratojmë edhe të ja përcjellim drejtorisë së financës me qëllim që të ndihmohet sepse ...

Enver Memolla . Nuk e miratojmë dot sot pa sjellë projektvendim drejtoria e financës.

Mukades Gixhari . Na e sjell mbledhjen e radhës.

Mitat Daja . Unë e kam çuar faktikisht por nuk është zgjedh.

Enver Memolla . Kërkesa dokumentacioni të ja çojë drejtorisë së financës të merret dhe të vijë herën tjetër.

Edison Memolla . Ne jemi dakord.

Mukades Gixhari . Dhe si Këshill po.

Mitat Daja . Në rregull.

Mukades Gixhari . Ndonjë diskutim tjetër?



Gezime Met-hasani . Kisha unë diçka. Në Sinaballaj këto shtëpiat e tërmetit që janë dy familje që i njoh shumë mirë, që zbrazën shtëpinë se do i vijë... nuk e di për një javë dhe deri tani rrijnë shumë keq nëpër... biles një e kam unë tek shtëpia ime edhe tjetra ka shkuar tek shtëpia e vëllait përkohësisht.

Edison Memolla . Njoftoji këto dy persona të vijnë nesër tek Bashkia dhe shikojmë anën procedurale se ku kanë ngecur. Çdo person kur ka filluar rindërtimi i shtëpisë e ka kontratën e ndjek vetë procesin, do parë çfarë faze është e parë apo e dytë. Të vijë nesër tek Bashkia çfarëdo lloj ore të jetë ta shikojmë dokumentacionin ta marrin me vete dhe të shikojmë për zgjidhjen.

Enver Memolla . Diçka doja më shumë për informacion për sa i përket kanalit Peqin-Kavajë që ka filluar rikonstruksioni do bëhet një pastrim total për pjesën e Rrogozhinës flas apo...? Më fal se kam parë në dy tre vende që si duket nga pamundësia se është zënë rruga kanalit siç e kemi ne nuk është pastruar , do pastrohet apo do rrijë thjeshtë vetëm me pjesën e meremetimit?

Edison Memolla . Atëherë sipas takimit që patëm me ministrin para pak ditësh gjërat kryesore se është me faza nuk përfundon i gjithë njëherësh se është i gjatë nuk arrin në kohë. Faza e parë parashikon gjithë pikat ku kanë qenë pika të rrezikshmeurat mbikalimet aty ku bashkohet ura me pjesën e dheut ku mbështetet. Do mbarojë kjo fazë pastaj do vazhdojë faza tjetër në dijeninë time do vishet i gjithi me çimento.

Enver Memolla . Edhe diçka për sa i përket Rrogozhinës pjesa nga ura e kanalit deri tek rruga e burgut është problem zona e urës se aty është ngushtuar shumë.

Edison Memolla . Do ngrëhet 20 cm .

Enver Memolla . Aty ka nevojë emergjente për pastrimësthtë bllokuar gjysma unë e kam parë vetë ndaj po them se ato shtëpi aty rrezikohen.

Edison Memolla . Meqë nuk i takon Bashkisë Rrogozhinë nuk do të thotë që ne nuk merremi me këtë punë është Bordi i Kullimit që e ka. Ne i kemi dërguar kërkesa të njëpasnjëshme Bordit të Kullimit, ministrisë së bujqësisë, tani ky projekt është meremetim i të gjithë problematikave të kësaj... se ka 40-50 vjet që nuk është pastruar ne e dimë. Rrogozhina të paktën do jetë tek fazat e shpejta nga lagja jote tek hyrja deri në dalje se e kemi kërkuar dhe ne shpejt me ngulm. Tani ka disa shtëpi që janë afër tani ka ardhur shtëpia tek kanali apo anasjelltas çfarë të themi...

Enver Memolla . Unë sapa ta thashë kanë zënë rrugën e kanalit dhe kanë ngelur disa pjesë që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

thjeshtë janë prekur dhe nuk kanë shkuar deri në fund. Gjëja tjetër ishte për pjesën e kanaleve kulluese të treta dhe të para që janë për bordin e kullimit ai është problem i madh.

Edison Memolla . Bordi i Kullimit ka qenë ndihmë faktikisht edhe në pastrimin e 30 km kanal që nuk ka ndodhur ndonjëherë, ne e thamë që do kemi dhe bashkëpunimin e atyre këtu është dhe pjesa e mjetit që nuk arritëm dot ta merrni. Mbledhjet e ardhshme do diskutojmë pak më gjatë për këtë gjë.

Indrit Dedej . Ka një kërkesë të një qytetari me emrin Demir Tahiri i kam thënë dhe vetë drejtorit të shërbimeve Olsit, unë ja kam thënë dhe personalisht.

Enver Memolla . Është lagja nr.2, rruga “Bërdedaj”.

Edison Memolla . Mbaje shënim ta verifikojmë.

Indrit Dedej . E mira është të verifikohet.

Mukades Gixhari . Atëherë diskutime të tjera? Meqë nuk kemi më diskutime mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 13 : 20⁰⁰ . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 49 min ; 07 sek).

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 18 (tetëmbëdhjetë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera